



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1462 Prot.

Tiranë, më 27. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 149, Datë 27. 10. 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 91, datë 11.08.2020, e paraqitur nga B.L kundër Bashkisë Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga B.L, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 252, datë 21.12.2015, është komanduar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit pranë zyrës së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe nga data 20.07.2016 është komanduar në pozicionin e K/inspektorit pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Mat. Detyrën e K/inspektorit e ka ushtruar deri në datë 08.10.2019, kur me Urdhrin nr. 453, datë 03.10.2019 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës” është larguar nga puna me motivacionin: “Mospërmbushje të detyrave funksionale”. Bashkia Mat në vazhden e kundërvënies dhe abuzivitetit ndaj tij, ka nxjerrë shkresën nr. 2535, datë 09.09.2019 “Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, në kohë të papërshtatshme, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë me paaftësi të përkohshme për punë, fakt i cili provohet me raportet mjekësore nr.235209, datë 09.09.2019 dhe nr.56646, datë 17.09.2019, dhe më pas shkresa nr. 3124, datë 03.10.2019 e Kryetarit të Bashkisë Mat “Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”. Ankuesi shprehet se nuk ka pasur asnjë masë

¹ Referuar kartës së anëtarësisë datë 16.05.2014, B.L është anëtar i subjektit politik: Partia Demokratike e Shqipërisë. Referuar Vërtetimit nr. 26, datë 28.10.2019 të lëshuar nga Partia Demokratike, Dega Mat, B.L që nga viti 2014 ushtron funksionin e Kryetarit të Seksionit nr. 9 të Partisë Demokratike të qytetit të Burrelit.

disiplinore, përkundrazi ka qenë i vlerësuar në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e detyrimeve që buronin nga kontrata e punës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 91, datë 11.08.2020 të B.L u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1141/2, datë 13.08.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Bashkia Mat për ankesën e bërë nga B.L si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Kopje të plotë të emërimit të B.L në Bashkinë Mat dhe kopje të kontratës së punës.
 - Kopje të procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si dhe parashtrime lidhur me shkakun e zgjidhjes së kontratës me B.L (fakte dhe prova).
 - Informacion për punonjës të tjerë që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të performancës së dobët në përmbushjen e detyrave funksionale, që nga data 01.10.2018 deri në datë 09.09.2019.
 - Informacion dhe kopje të procedurës së emërimit të zëvendësueses/it, nëse ka.
 - Kopje të “Rregullores së Disiplinës për punonjësit e Bashkisë, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me Kodin e Punës” dhe kopje të “Kodit të Etikës së Bashkisë Mat”.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitin 2017, 2018 dhe 6-mujorin e I-2019 dhe të masave disiplinore për punonjësin B.L.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve.
- Duke qënë se Bashkia Mat nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë përgjigje, me anë të shkresës Nr. 1141/3, datë 16.09.2020, Komisioneri i dërgoi një kujtesë lidhur me shkresën Nr. 1141/2, datë 13.08.2020.

Me shkresën nr. 3431/2, datë 22.09.2020, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Mat në mes të tjerash informoi se: *“Lidhur me pretendimin, për sjellje diskriminuese të Kryetarit të Bashkisë Mat ndaj ankuesit për shkak të bindjeve politike, bëjmë me dije se është një pretendim i pabazuar në fakte konkrete, por i ngritur thjeshtë për vetvlerësim politik nga ana e ankuesit. Kjo për faktin se në funksionin politik që ai pretendon se ushtron apo të ngjashëm me të, ka me dhjetra, madje që vijojnë që të jenë edhe pjesë e administratës aktuale. Gjithashtu bëhet me dije se në stafin aktual të Bashkisë vijojnë të punojnë në pozicionet e mëparshëm apo të ngjashme, pjesa më e madhe e stafit të mëparshëm të Bashkisë Mat, para ndryshimit të Kryetarit të saj, pas zgjedhjeve të 30 qershorit 2019, siç janë të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pjesa më e madhe e stafit të Sektorit të Tatimeve dhe Taksave Vendore, etj. Pretendimi i ankuesit se ka qenë me raport paaftësie, është i pavërtetë, pasi shkresa “Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës” është lëshuar në datë 09.09.2019, nr. 2535, dhe është fakt interesant që pikërisht atë ditë është sëmurë. Ndër të tjera, theksojmë se afati i raportit të parë ka qenë deri në datë 14.09.2020, pas kësaj date ankuesi duhej të paraqitej në punë. Përsëri, ankuesi ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë për datat 17-18 shtator 2019. Gjatë gjithë kësaj periudhe, të gjitha afatet procedurale janë pezulluar dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim i mëtejshëm procedural. Kjo konfirmohet nga fakti se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe akti përkatës për ndërprerjen e tyre është dërguar në datën 03.10.2020, respektivisht me nr. 3124 dhe nr. 453 të urdhërit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Sikundër është përshkruar më sipër, ankuesit i është lënë e gjithë hapësira ligjore për të paraqitur objeksionet e tija në përputhje me ligjin, madje*

i është lënë afati ligjor në limitet e tij në favor të ankuesit dhe në asnjë rast nuk i është shkelur asnjë e drejtë apo të jetë vepruar në kushtet e paligjshmërisë, dhe nuk ka asnjë mbivendosje afatesh në datat me raport paaftësie të përkohshme të paraqitura nga ankuesi, e kundërta është e vërtetë, ai është përpjekur të kryejë “manovra” të padenja për një zyrtar nëpërmjet raporteve mjekësore, për të shtyrë në gabim punëdhënësin gjatë procedurës për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Ankuesi brenda muajit shtator ka munguar pa arsye në datat 16, 24 dhe 26 dhe për asnjë ditë nuk ka parashtruar arsye për mungesën në punë. Duke qenë se ka qenë në proces e sipër procedura për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, e cila lidhej posaçërisht me mospërbushjen e detyrave funksionale, nuk janë ndërmarrë veprime të veçanta për këtë fakt, por janë ndëshkuar nga pikëpamja administrative duke mos i paguar ato ditë pune. Ankuesi, duke vepruar në këtë mënyrë, përfshirë dhe këto shkelje disiplinore (duke mos anashkaluar edhe anën profesionale), ka provuar se me veprimet dhe mosveprimet e tij është bërë vetë shkaktar i fillimit të procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe nuk do kishte arsye askush që të ndërmerre hapat vijues ligjor për largim nga puna të ankuesit, nëse do të kishim të bënim me një punonjës të përkushtuar të aftë profesionalisht dhe të disiplinuar, ashtu sikundër ka ndodhur me shumë të tjerë që vijnë në ditë të sotme në pozicionet e punës që kanë patur apo të ngjashme. Shkaku i largimit nga puna është pasqyruar në aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës “Urdhër” nr. 453, datë 03.10.2020 dhe ka të bëjë me një sërë rrethanash në ushtrimin e funksionit të tij zyrtar si Kryeinspektor i IMT, që kanë demonstruar mospërbushje të detyrave funksionale nga ana e tij. Janë evidentuar se kemi të shtrirë në kohë një numër masash administrative (Vendime për dënim me gjobë) të Kryeinspektorit të IMT, të cilat megjithëse rezultojnë të materializuara në proces-verbalet tip me numër serie dhe të gjithë elementët e tjerë sipas ligjit në fuqi, në vijim nuk është ndërmarrë asnjë masë për ekzekutimin e tyre përfundimtar, duke mos bërë asnjë rakordim mbi gjendjen e tyre me asnjë person përgjegjës në Bashki, përmendim këtu në veçanti, Sektorin e Financës dhe atë të Tatimeve dhe Taksave Vendore, ku duhej të bëhej rakordimi për të përcaktuar të ardhurat dhe marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre, pasi fletë-gjobat në vetvete janë letra me vlerë, si dhe sipas rregullave financiare dhe buxhetore në fuqi, çdo fund viti duhej të dorëzoheshin fizikisht pranë financës për tu maturuar dhe njohur si debi. Gjithashtu, në vijim të kërkesës së Kryetarit të Bashkisë, për informacion mbi punën e kryer nga ana e IMT-së dhe të tijën si drejtues i saj, në fillim të muajit gusht 2019, nuk është pasqyruar asnjë detyrë e përmbushur nga ana e tij si Kryeinspektor i IMT-së, duke mos paraqitur asnjë informacion mbi situatën konkrete në sektorin që ai mbulon, gjë e cila është detyrim i tij ligjor. Për sa më sipër, rezulton se kemi të bëjmë me shkelje konkrete të punëmarrësit dhe të gjitha këto përbëjnë fakte të vullnetit dhe veprimeve apo mosveprimeve të B.L. në cilësinë e Kryeinspektorit të IMT-së. Për këtë arsye, shkeljet dhe mospërbushja e detyrave funksionale të B.L. patën krijuar një situatë të rëndë që nuk lejonte, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohej punëdhënësit vazhdimi i mëtejshëm i marrëdhënieve të punës. Lidhur me punonjës të tjerë që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të performancës së dobët, ju bëjmë me dije se ka patur disa të tillë. Konkretisht, janë disa nga administratorët e njësive administrative, vijnë me Xh.D,

pozicioni i punës Përgjegjës i Sektorit të Gjelbërimit, A. D, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake, etj. Mënyra e zëvendësimit të ankuesit në pozicionin e punës së Kryeinspektorit të IMT-së, duke qenë se nuk është pozicion pune pjesë e shërbimit civil, është bërë duke u bazuar në të dhënat e dosjeve personale të personave, të cilët kanë paraqitur kërkesa për këtë vend pune dhe në përfundim të shqyrtimit të dosjeve të personave që kanë paraqitur kërkesat është bërë dhe renditja e tyre. Lidhur me vlerësimet e punës së ankuesit, informohet se në dosjen e punonjësit nuk është gjetur asnjë vlerësim pune nga eprori i mëparshëm apo dhe masë disiplinore. Gjithashtu njoftohet se çështja po ndiqet gjyqësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Mat, B.L me shkresën datë 05.10.2020 ka dërguar kundërshtimet si vijon: *“Pretendimet e Bashkisë Mat në shkresën Nr. 343/2, datë 22.09.2020, nuk qëndrojnë, pasi referuar shkresës Nr. 2535, datë 09.09.2019, “Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, ky njoftim dhe kjo procedurë ka filluar në kohë të papërshtatshme sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë, fakt i cili provohet mjaft qartë me raport për paaftësi të përkoshme në punë, nr. 235209, datë 09.09.2019, raport për paaftësi të përkoshme në punë, nr. 56646, datë 17.09.2019, dhe në rastin konkret Bashkia Mat duhet të pezullonte shkresën nr. 2535, datë 09.09.2019, “Njoftim për fillimin e pocedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, dhe të rifillonte njoftimin dhe procedurën pas përfundimit të kësaj periudhe, sipas nenit 147 të Kodit të Punës. Lidhur me mosrealizimin e detyrave të pretenduar nga Bashkia Mat, nuk qëndrojnë, pasi detyrat e K/inspektorit të IMT-së, janë të përcaktuara në nenin 5, të Ligjit 183/2014, “Për Inspektimin e Ndërtimit”.*

- Me shkresën nr. 1368, datë 08.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Mat, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të urdhrit të pezullimit të afateve procedurale për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
 - Informacion lidhur me, kohën dhe mënyrën si ka marrë dijeni Bashkia Mat, për mungesën në punë të ankuesit, për arsye shëndetësore, në datë 09.09.2019 dhe 17.09.2019 dhe nëse është paguar ankuesi për ditët që ka qenë me raport mjekësor.
 - Kopje të procedurës së përdorur nga Bashkia Mat për rakordimin dhe arkëtimin e fletë gjobave të vendosura nga drejtoritë e bashkisë dhe kopje të raporteve vjetore për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019 në të cilat evidentohet mungesa e rakordimit mes drejtorive.
 - Kopje të përshkrimit të punës dhe detyrave për pozicionin, Drejtor i IMT-së të Bashkisë Mat, deri në datë 09.09.2019.
 - Kopje të kërkesë padisë të bërë nga B.L dhe kopje të deklaratës së mbrojtjes së Bashkisë Mat.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet e-mailit datë 16.10.2020, Bashkia Mat vendosi në dispozicion të Komisionerit, kopje të kërkesë padisë, deklaratën e mbrojtjes të paraqitur në gjykatë nga Bashkia Mat dhe Vendimin nr. 152, datë 29.09.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë nga palët pranë Komisionerit gjatë zhvillimit të procedurave të shqyrtimit të ankesës, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat³, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga B.L për trajtim të paligjshëm, për shkakun e pretenduar për diskriminim, si bindja politike është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Kjo reflektohet në pikën 3 të objektit të kërkesë padisë në të cilën ankuesi ka kërkuar: *“Detyrimin e palës së paditur Bashkia Mat, për dëmshpërblim paditësin me 12 muaj pagë si zgjidhje e pajustificuar dhe pa shkaqe të arsyeshme”* dhe në bazën ligjore, në të cilën i është referuar nenit 9 (Ndalimi i diskriminimit) të Kodit të Punës dhe Konventës nr. 111, 15.06.1960 *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit”*.

Gjatë arsytimit të kërkesë padisë së bërë nga ankuesi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në faqen 6 (gjashtë) të saj, citohet se: *“Gjithashtu në pretendim se kontrata është zgjidhur për shkak të bindjeve politike, pasi nga muaji gusht deri në tetor 2019 janë larguar nga puna 85 specialistë të Bashkisë Mat, dhe detyra e tij ka qenë K/inspektor pranë IMT-së, që punonte me ligjin specifik nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, dhe një fakt tjetër që provon qartë largimin e tij abuziv nga puna dhe për arsye politike është se ai është anëtar i PD-së dhe Kryetar i Seksionit (-të të PD-së, nga viti 2014 e në vazhdim në qytetin e Burrelit, dhe për periudhën e marrëdhënieve të punës prej 4 vitesh nuk ka asnjë masë disiplinore për këtë periudhë, mjafton të citojmë dispozitën e nenit 146 të Kodit të Punës”*.

Gjithashtu, gjatë arsytimit të kërkesë padisë, ankuesi në faqen 4 ka cituar se: *“Në rastin konkret, referuar shkresës nr. 2535, datë 09.09.2019 “Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” është bërë në kohë të papërshtatshme, në periudhën e paaftësisë së përkohshme për punë gjë të cilën ligji e ndalon, jemi para një trajtimi të pabarabartë (diskriminim)”*.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Në kërkesë padinë për pavlefshërinë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, ankuesi i është referuar dhe nenit 9 të Kodit të Punës në të cilën shkruhet se: 1. *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është pretenduar dhe tek Komisioneri. Nëse në ankesën e paraqitur pranë KMD-së ankuesi ka pretenduar për diskriminim për shkak të bindjes politike, në kërkesë padinë e paraqitur para gjykatës, në referim të të njëjtit shkak, ka kërkuar zgjidhjen e pasojave të ardhura në referim të dispozitave dhe të nenit 146 të Kodit të Punës dhe Konventës nr.

³ Referuar Dëftesës së Komunikimit nr.95/386, datë 07.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

111, 15.06.1960 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit”.

Në vijim të kërkesë padisë së bërë nga ankuesi, Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Mat, me Vendimin nr. 152, datë 29.09.2020⁴, ka vendosur: *“1. Rrëzimin e kërkesë padisë të paditësit B.L si të pabazuar në ligj e prova. 2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë”*.

Në mes të tjerash, në arsyetimin e vendimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat është shprehur se: *“Fq. 8: Gjykata çmon se nga analiza e fakteve dhe dispozitës së sipërpërmendur, zgjidhja e kontratës së punës e lidhur midis palëve ndërgjyqëse, është bërë në mënyrë të justifikuar duke respektuar procedurën e largimit nga puna”, po në fq. 8 Gjykata është shprehur se: “Gjykata vlerëson se pala e paditur (Bashkia Mat) ka mundur të zbatojë e dokumentojë procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës me paditësin (B.L)”*.

Në vendimin e sipërcituar, Gjykata në faqen 10 është shprehur se: *“Sa më sipër nuk provohet edhe në këtë pretendim se largimi i tij nga puna është për shkaqe politike,”*.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka shqyrtuar kërkesë padinë e B.L dhe është shprehur me vendim për rrëzimin e pretendimeve të tij për diskriminim për shkak të bindjes politike.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen.

Në kontekst të sa më sipër, në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte e rrethana janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor; atëherë konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

Përsa më sipër, pavarësisht dokumentimit të bindjeve politike të ankuesit, në kushtet kur kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 3 të tij parashikon se: “Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim”, ndërsa në pikën 4, citohet se: “Gjykata mund t’i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.”

⁴ Vendimi i është komunikuar palëve me shkresën “Dëftesë Komunikimi” nr. 234, datë 06.10.2020.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36, të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenin 90, pika 3 e Kodit të Proçedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën e hetimit të ankesës Nr. 91, datë 11.08.2020, të shtetasit B.L, pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar në Gjykatë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Bindje politike)

(Fusha: Punësim)